

AKT LIKUIDIMI

I

SHOQERISE "PRADIUMTECH" SH.P.K (NE LIKUIDIM E SIPER)

DREJTUAR:

QENDRES KOMBETARE TE BIZNESIT

TIRANE

Të nderuar,

Ne kuadrin e misionit, si likujdator i Shoqerise ne Likujdim e Siper "PradiumTech Shpk", verifikuam gjendjen financiare si dhe kryem operacionet e likujdimit te kesaj shoqerie dhe ne perfundim paraqesim Aktin per likujdimin e saj si me poshte vijon:

Shoqeria "PradiumTech Shpk ", eshte regjistruar ne QKB në date 18.03.2019 me objekt aktiviteti kryesisht ne ofrimin e sherbimeve ne fushen e teknologjise se informacionit dhe komunikimit (TIK).


Me date 29.01.2020 nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise "PradiumTech" Shpk eshte marre vendimi per prishjen e shoqerise dhe fillimin e procedurave te likuidimit te saj ne gjendjen e aflesise paguese. Me kete vendim eshte emeruar si likuidator Z.Alban BERBERI, me qellimin e permbushjes se te gjitha veprimeve te nevojshme nga ana e tij per praktiken e likuidimit te shoqerise.

Ky vendim eshte depozituar ne QKB me date 20.02.2020 dhe kjo e fundit e ka shpallur shoqerine "PradiumTech" shpk , shoqeri ne likujdim e siper.

Ne zbatim te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar si dhe ne baze te normave te profesionit, verifikuam dokumentet financiare dhe te gjitha llogarite pasurore te shoqerise "PradiumTech" Shpk.

Ne baze te Pasqyrave Financiare date 31.12.2020 te hartuara nga shoqeria ne zbatim te Ligjit Nr. 8228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si dhe duke marre parasysh dokumentat kontabile per veprimet financiare te kryera nga shoqeria gjate periudhes 31.12.2020 deri me 01.01.2021, hartuam Bilancin e Celjes se Likujdimit te saj me date 01.01.2021.

Per mbylljen e llogarive te Bilancit te dates 01.01.2021 , i cili ishte edhe Bilanc i Celjes se Likujdimit, u ndermoren operacionet e nevojshme te likujdimit, duke kryer veprimet financiare te mbylljes se llogarive te mbartura ne momentin e celjes se likujdimit.



Nderkohe u rakordua per situaten tatimore me Degen Rajonale te tatimeve Tirane , u bene sistemimet dhe pagesat e nevojshme dhe ne perfundim ne nuk na figuron ndonje borxh ndaj ketyre organeve .

U derguan ne QKB – njoftimet perkatese per te vene ne dijeni kreditorët qe mund te kishin pretendime ndaj shoqerise ne likuidim e siper “PradiumTech “ Shpk , por deri ne daten e sotme, prane shoqerise nuk eshte paraqitur ndonje pretendim.

Mbi kete baze, pas kryerjes se operacioneve te likujdimit, u procedua per mbylljen e llogarive sipas kerkesave te Standarteve Kombetare Kontabile dhe u hartua Bilanci Likujdimit date 31.10.2021.

Procesi i likujdimit te shoqerise rezultoi me nje humbje prej **24.220 Lek**, si rrjedhim i pagesave te bera per pagesen e detyrimeve tatimore.

P E R F U N D I M I

Sipas Bilancit te Likujdimit date 31.10.2021, Shoqerise “PradiumTech” Shpk nuk i mbetet asnje vlere pasurore. Te gjitha llogarite e shoqerise jane bere zero. Pas marrjes se vendimit nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise per miratimin e ketij Akti dhe depozitimin e tij ne QKB, shoqeria “PradiumTech”Shpk konsiderohet e mbyllur.

Tirane, me 15.11.2021

LIKUIDATOR

ALBAN BERBERI

